

-----Mesazhi origjinal-----

Nga: Shukri Latifi [<mailto:shukril@gmail.com>]

Dërguar: Tuesday, July 02, 2019 3:16 PM

Për: urbanizmi prishtine <urbanizmiprishtine@rks-gov.net>

Tema: Arberia 3

Persherndetje te nderuar,

\lidhur me kerkesen numer 05-350/02-0122265/19 te dates 28.05.2019, per ndertimin e objektit afaristo banesor B+S+P+4+Ph ne parcelat 07171-1 dhe 07171-2 ne Zk Prishtine, kemi shume ankesa.

E para, me ndertimin e ketij objekti, lagjes me te bukur ne qytet po i shtohet nje objekt i shemtuar.

E dyta, qytetareve ne kete lagje po u prishet qetesia.

E treta, po rritet numri i banoreve qe kjo lagje nuk i perballon numer me te madh sepse nuk ka shkolle, nuk ka qerdhe, nu ka kanalizim dhe ujesjelles per kapacitet me te madh te banorve. E katerta, me kete objekt humbet gjelbrimi, ne krahasim me ate sikur te ishin ndertuar shtepi aty.

E pesta, ne vend te dy familjeve, lagjes do i shtohen 50 sosh me nga 5 anetar, qe do te jene 250 banore me shume. 50 vetura me shume, parking nuk ka. Tani me objektet qoroditese ekzistuese po eshte e ngulfatur rruga e lagjes (Halim Spahija) per shkak te veturave ne rruge. Rruga e gjere 5m nuk e perballon nje objekt te tille ne mes te lagjes.

Ju po e shkatrron per cdo dite lagjen me te mire ne qytet, po e shkatrron pasurine e qytetareve.

Për: Shukri Latifi

Nga : Drejtoria e Urbanizmit, Komuna e Prishtinës

Subjekti: Përgjigje banorit të lagjes “Arbëria 3” në shkresën “Ankesë në Kushte
Ndërtimore të propozuara për parcelat kadastrale 07171-1 dhe 07171-2 Z.K Prishtinë

Data: 10.01.2020

Bazuar ne ankesën tuaj të parashtruar përmes postes elektronike me dt. 02.08.2019, lidhur me ‘Njoftimin Publik’ sipas kërkesës për kushte ndertimore nr. 05 nr.350/02-0122265/19 dt.28.05.2019 të pronarëve Ruzhdi Aliu dhe Shefki Gashi, me investitor N.T.P “Butrinti” për caktimin e kushteve ndërtimore për parcelat kadastrale 7171-1 dhe 7171-2 Z.K Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit pas shqyrtimit të saj ju informon si në vijim:

Projekt propozimi i prezentuar në “Njoftim Publik” është në harmoni me kriteret e Planit Rregullues përkatësisht “Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues Arbëria 3” i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal 01-35-94056 dt. 04.05.2015. Blloku Urban B9.1 është i planifikuar për banim të mesëm me etazhitet P+4 me indeksin e shfrytëzimit të parcelës ISHP - 30% dhe sipërfaqe gjelbëruese ISGJ- 40%. Gjithashtu në kuadër të këtij blloku janë planifikuar rrugët me standarde si dhe lokacioni per shkollë.

Lidhur me “Zgjidhjen Urbane” dhe mundësinë e zgjerimit të saj, në Drejtorinë e Urbanizmit është mbajtur një takim me dt. 09.08.2019 ku janë ftuar banorët e lagjes përkatësisht pronarët e parcelës kadastrale 6175-0 Z.K Prishtinë, në lagjen “Arbëria” që kufizohet me parcelat 7171-1 dhe 7171-2. Në takim ishin prezent tre pronarë, investitori dhe projektuesi. Pronarët në këtë takim kanë deklarua se distancohen nga E-maili që ju e keni dërguar në Drejtorinë e Urbanizmit lidhur me projekt propozimin e prezentuar me “Njoftimin Publik”.